



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUPENI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA  
SKENDERAJ

Nr. 03-052/01-0006015/23

Data 31.01.2023



**Komuna Skenderaj**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Administratë / Direkcija za Administraciju / Department for Administration**

## **RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022**

**Janar, 2023**

Drejtoria për Administratë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore ka hartuar raportin vjetor për vitin 2022, i cili pasqyron punën një vjeçare të kësaj drejtorie në përpjekje për të përmbushur detyrimet dhe obligimet tona në raport me qytetarët, komunitetin e biznesit, shërbimeve tjera, planit të punës e gjithashtu edhe në raport me ministrinë e linjës. Objektivi i kësaj drejtorie për vitin 2022 ishte avancimi i shërbimeve tona në Qendrën për shërbime më qytetarë në bashkëpunim më MAPL-në, Gjendjes Civile në bashkëpunim më ARC-në për Zyrën qendrore në Skenderaj, po ashtu edhe në Zyrat e Vendit në teren. Përdorimi i sistemeve elektronike për shërbime që këto shërbime të jenë transparente, cilësore dhe të shpejta për të gjithë qytetarët, menaxhimi i zyrës për barazi gjinore dhe të drejta e njeriut, integrimi evropiane, IT, autoparkut, si dhe hartimi i akteve normative që bie mbi përgjegjësinë e drejtorisë së administratës si lista e shenjave të klasifikimit të dokumenteve me afatet e ruajtjes dhe kodin i etikës.

Në vazhdim paraqesim raportin e sektorëve, njësive, zyrave dhe shërbimeve në Drejtorinë e Administratës:

## **SEKTORI I GJENDJES CIVILE**

Sektori i Gjendjes civile në Skenderaj, ka punuar sipas planit të punës për vitin 2022, ligjit për Gjendjen civile dhe udhëzimeve administrative nga MPB-ja dhe ARC-ja. Është bërë përdorimi i sistemit elektronik të gjendjes civile dhe intranetit nga Zyrtaret e Gjendjes civile si në Zyrën qendrore në Skenderaj, po ashtu edhe në Zyrat e Vendit në teren. Në këtë shërbim janë kryer të gjitha punët e administrimit të dokumenteve (kërkesave/parashtrësive dhe akteve tjera) siç janë: pranimi i kërkesave, regjistrimi i kërkesave, udhëzime qytetarëve, lëshimi i çertifikatave të gjendjes civile, regjistrimi lindjeve, vdekjeve dhe martesave si dhe dokumenteve tjera shtesë që i përkasin këtij sektori.

Sektori i gjendjes civile në Komunën e Skenderajt, më hapësirën që ka në zyrën qendrore në Skenderaj se bashku më 6 (gjashtë) zyrat e vendit në teren ka kryer detyrat e punës në maksimum për të arritur objektivat e tyre në përputhshmëri më ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi, Zyra Qendrore në Skenderaj ka funksionuar dhe ka bashkëpunuar me të gjitha zyrat e vendit në teren, më konsullatat e Republikës së Kosovës jashtë vendit dhe Agjencionin e Regjistrimit Civil në Prishtinë.

Numri i dokumenteve personale që janë shërbyer vetë qytetarët nga **E-Kioska** sipas sistemit elektronik të Gjendjes civile për vitin 2022 është **4190**. Në vijim kemi edhe raportin e lëshimit të dokumenteve të gjenjdes civile të radhitura sipas sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme- ARC-së.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

## LISTA E DOKUMENTEVE TË LËSHUARA

Periudha e raportimit: 01/01/2022 - 31/12/2022

### DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM

# Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1 Skenderaj	1547	13232	62	2659	1326	945	897	2529	461	23658
<b>TOTALI</b>	<b>1547</b>	<b>13232</b>	<b>62</b>	<b>2659</b>	<b>1326</b>	<b>945</b>	<b>897</b>	<b>2529</b>	<b>461</b>	<b>23658</b>

## LISTA E DOKUMENTEVE TË LËSHUARA

Periudha e raportimit: 01/01/2022 - 31/12/2022

### DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË JASHTËM

# Komuna	Certifikat ë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendj es Civile	Certifikatë e shtetësis ë	Certifikat ë e martesë s	Certifikat ë e vdekje s	Certifikatë e vendbanimi t	Certifikatë e gjendjes martesor e	Deklaratë e bashkësis ë familjare	Vërtetim nga arki vi	Totali
1 Skendera j	10218	8296	243	5622	854	1471	723	5160	366	32953
<b>TOTALI</b>	<b>10218</b>	<b>8296</b>	<b>243</b>	<b>5622</b>	<b>854</b>	<b>1471</b>	<b>723</b>	<b>5160</b>	<b>366</b>	<b>32953</b>

## **QENDRA PËR SHËRBIMIN E QYTETARËVE/ARKIVA**

Qendra ka bërë pranimi i kërkesave, regjistrimin e kërkesave, udhëzime qytetarëve, dhe ka proceduar për trajtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në njësitë organizative të komunës.

Përdorimi i dy sisteme elektronike, Intraneti dhe SMAED qe kanë të bëjnë më sistemin e menaxhimit të dokumenteve në komunë.

Është bërë pranimi i dokumenteve, pranimi i postës, evidencimi dhe bashkimi i shkresave, vulosja e shkresave dhe lëndëve, skanimi i dokumenteve dhe bashkëngjitja e tyre lëndëve, dërgimi i akteve dhe lëndëve në procedim, dërgimi i postës, shpërndarja e postës dhe e lëndëve, duke përfshirë edhe postën elektronike, arkivimin e lëndëve të njësjive organizative të komunës dhe vënia e tyre në Depon e Regjistraturës, si dhe mbajtja e të gjitha vulave katrore dhe rrethore.

Është hartuar lista e shenjave të klasifikimit të dokumenteve më afatet e ruajtjes, ku është dhënë pëlqimi nga Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës.

Në vitin 2022, posta e cila është pranuar dhe dërguar nga Qendra për Shërbimin më Qytetarë/Arkivit në bazë të librave përkatëse, do të i japim si në vijim:

Në librin e ekspedicionit në vend qe është për shpërndarjen e postës se thjeshtë (zakonshme) brenda Komunës së Skenderajt, përmes këtij libri janë dërguar në adresa të caktuara gjithsejtë **1983** shkresa.

Në librin e dorëzimit të postës personalisht qe është për postën rekomande, nga fahu postal i Komunës në PTK-në, janë pranuar gjithsejtë **375** shkresa.

Në librin e postës së dërguar nga komuna për në PTK-në, për në adresat e caktuara, janë dërguar gjithsejtë **767 shkresa.**

Në Qendrën për shërbime më Qytetarë/arkivë nga data **01/01//2022** deri më datën **31/12/2022**, janë pranuar gjithsejtë **64500** lëndë për të gjitha organet e komunës së Skenderajt ( Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës dhe të gjitha Drejtorive ), ku e kemi të pasqyruar si në vijim:



## Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

01/01/2022 - 31/12/2022

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Procesi	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Posht	Pezulluar	Ceduar	Anulluar	Perfunduar	Totali
	NUK EXISTON DEPARTAMENT por ka Lende	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
DA	Drejtoria për Administratë	2	0	3,524	9	0	5	0	47	37,659	41,246
DA	Drejtoria për Arsime	0	437	546	616	0	0	0	14	0	1,613
DBPZHR	Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	0	412	99	0	0	0	21	0	532
DEFZH	Drejtoria për Financa Ekonomike dhe Zhvillim	0	5	8,852	3	16	0	0	14	0	8,890
DKRS	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	5	132	65	7	2	0	2	0	213
DUNMA	Drejtoria për Urbanizim dhe Mbrojtje të Ambientit	0	107	582	1	0	0	0	16	0	706
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike	0	13	247	27	0	71	0	10	0	368
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	0	25	2,495	58	0	318	0	180	0	3,076
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, KP	4	94	5,225	32	0	0	0	43	0	5,398
KK	Kuvendi i Komunës	0	0	137	1	0	0	0	5	0	143
KK	Kryetari i Komunës	0	133	1,658	8	0	12	1	32	0	1,844
DZHENIT	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0	0	58	23	1	4	0	3	0	89
DIK	Drejtoria e Inspektoratit Komunal	0	4	343	26	0	0	2	6	0	381
		6	824	24,211	968	24	412	3	393	37,659	64,500

## **NJËSIA E AUTOPARKUT**

*Kjo njësi ka pranuar kërkesat e sektorëve të ndryshëm të komunës për transportin e zyrtarëve në udhëtime zyrtare, është kujdesur për gjendjen e automjeteve zyrtare, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre. Ka mbajtur evidence për nisjet dhe kthimin e tyre në orarin zyrtar, regjistrimin e tyre sipas rregullave në fuqi etj.*

## **ZYRA PËR PËRKTHIME**

Zyrtari për përkthime ka përkthyer 490 dokumente, duke përfshirë të gjitha aktet që janë nxjerr nga ekzekutivi dhe kuvendi komunal si; vendime të ndryshme ,rregullore, konkurset, akt emërimit ,kërkesa dhe shkresa tjera zyrtare, duke respektuar obligimet ligjore në aspektin e dygjuhësisë. Njëkohësisht ky zyrtar ka bërë edhe përkthim simultant në takimet e ndryshme me komunitetin pakicë në komunën e Skenderajt..

## **NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Njësia komunale për të drejtat e njeriut , është si një mekanizëm përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës. NJMDNJ, Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt ,në bazë të Planit të Punës për vitin 2022 janë kryer këto aktivitete si në vijim:

- Shënimi i 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
- Organizimi i Festës së 1 Qershori-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.
- Rekomandime për drejtorinë e Arsimit, Bujqësisë, Zhvillimit Ekonomik ,si dhe atë për Kulturë Rini dhe Sport sa i përket ndarjes se subvencioneve dhe bursave.
- Raportimi në kohën e kërkuar për çështjen e zbatimit të Barazisë Gjinore dhe ato për të Drejtat e Njeriut nga MAPL- ZKM –OSBE etj.
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 për Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra Barazi Gjinore
- Takime të rregullta të Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje.
- Tetori muaji Kundër Kancerit të Gjirit (aktivitete të ndryshme njëmuajore).
- 18 tetor hapjen e fushatës vetëdijesuese në Parandalimin e Trafikimit me Njerëz (aktivitete gjatë 30 ditëve).
- Shpërndarja e posterëve vetëdijesues
- Ligjerata nëpër shkolla të nivelit Komunal kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër dhunës në familje në bashkëpunim më Policinë e Kosovës.

- Shënimi i Ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara 03.Dhjetori ,në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.
- Shënimi i 25 Nëntorit- Dita Ndërkombëtare për eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.(16-të ditë aktivizim).
- Shënimi i 10 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare për te Drejtat e Njeriut.
- Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme.

## **ZYRTARI PËR INTEGRIME EVROPIANE**

Gjatë vitit 2022, zyrtari për integritet evropiane, ka mundësuar koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me obligimet e komunës së Skenderajt në raport me integritet evropiane si dhe lehtësimin e kryerjes së atyre obligimeve, ka ofruar, këshilla, rekomandime, statistika, ka marrur pjesë në përcaktimin e prioritetëve komunalë, hartimin e dokumenteve strategjike dhe normative, planifikimin e buxhetit, mbështetje të proceseve dhe politikave që mundësojnë promovimin e vlerave evropiane, pranimin dhe plotësimin e pyetësorëve të MAPL-së në periudha 3 dhe 6 mujore mbi nivelin e përmbushjes së obligimeve të komunës së Skenderajt nga agjenda evropiane. Zyrtari ka ndjekur trajnime profesionale në fushën e integritetëve, mbi mbrojtjen nga diskriminimi, mbi “Modeli i vetëqeverisjes lokale” “Obligimet e komunave nga Agjenda Evropiane” si dhe trajnime mbi fushat përmes së cilës bëhet matja e performancës komunale nga MAPL dhe akterë-donator tjerë.

Ka mbajtur kontakte dhe bashkëpunim me MAPL, OSCE, OJQ, Zyrën për informim dhe bashkëpunim me publikun, zyrën për komunitet, zyrën për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, si dhe ka monitoruar punën e kuvendit komunal dhe drejtorive komunale. Në baza mujore ka komunikuar me drejtorë komunal dhe organe tjera komunale me ç’rast ka dhënë rekomandime mbi obligimet e komunës nga Agjenda Evropiane. Ka marrur pjesë në realizimin e aktiviteteve vetëdisuese për promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe mbrojtje nga diskriminimi, si dhe punë tjera.

## **ZYRA E TEKNOLOGJIS INFORMATIVE**

Përveç punëve të përditshme të zyrës së TI-së si: testimin e rrjetit, testimin e aplikacionit të Intranetit, gjendjes civile, tatimit në pronë, fribalancit, kadastrit, e-arkivës, e-pasurisë, ueb faqes zyrtare të komunës, 6 Zyrave të GJC, QKMF-së,



QPS-së, Zyrës së Punësimit, QRA-së, Gjykatës Komunale, Kompleksit Memorial "Adem Jashari" Zyrës për Komunitete  
eji. Zyra e TI-së ka kryer edhe këto punë

- Pajisja me licenca softuerike
- Janë Mirëmbajtur dhe mbikëqyrur vazhdimisht 3 linkat, me Gjykatën Komunale, QRC/QRA dhe QPS
- Është mirëmbajtur dhe mbikëqyrur vazhdimisht linku përmes fibrës optik në QKMF
- Është mirëmbajtur linku në Qendrën e Kulturës dhe Artit " Hasan Prishtina "
- Janë mbikëqyrë dhe mirëmbajtur vazhdimisht 6 linkat me Zyrat e Vendit, Kompleksi Memorial " Adem Jashari" dhe Zyrës për Komunitete në Bajë
- Është mirëmbajtur vazhdimisht Webfaqja zyrtare e komunës në aspektin teknik të administrimit
- Është mirëmbajtur konzola për menaxhim të e-Mailit zyrtar dhe futjes ne Domain Qeveritar të kompjuterëve të komunës
- Për çdo seancë të asamblesë komunale është montuar kamera e Teleprezencës dhe është transmetuar drejtpërdrejt seanca përmes webfaqes së komunës dhe janë ruajtur inçizimet
- Nga zyra e TI-së, janë bërë servisimet e mbi 100 kompjuterëve të komunës
- Janë futur në DOMAIN qeveritar rreth 16 kompjuterë të ri zyrtarë dhe janë rifitur në domen qeveritar rreth 20 kompjuterë të cilët kishin probleme të ndryshme me domenin qeveritar
- Janë instaluar apo riinstaluar rreth 70 printerë dhe skanerë
- Është mbikëqyrur dhe menaxhuar kontrata e AQP-se për shfrytëzim të paisjeve (fotokopje, printer skaner )me qera nga dt. 01 Janar 2020
- Janë instaluar 12 pajisje fotokopjuese sipas kontratës me AQP-në per paisje me qera
- Pjesëmarrja në takime dhe konferenca të ndryshme me Kolegjiumin e TI-ve
- Sipas nevojës është intervenuar në nëpër 6 Zyrat e Vendit. Kompleksin Memorial " Adem Jashari " dhe Zyrën e Komuniteteve rreth problemeve me rjetet dhe paisje si dhe per përdorim te kompjuterit dhe e-mailit zyrtar.
- Nga zyra e TI-së, sipas nevojës është asistuar tek të gjithë zyrtarët komunal për përdorim të kompjuterit, aplikacioneve, emailit zyrtar dhe sipas nevojave të zyrtarëve.
- Janë krijuar llogari të reja për zyrtarët komunal në aplikacionin e Intranetit
- Është bërë Back-up i vazhdueshëm i DB të aplikacionit e-Kontabiliteti.
- Kanë filluar të lëshohen të gjitha llojet e faturave përmes Aplikacionit të Intranetit
- Janë ruajtur raportet nga Aplikacioni i intranetit për vitin 2022
- Janë krijuar dhe aktivizuar llogari të reja zyrtare për të gjithë zyrtarët e ri të cilët janë punësuar në komunë
- Është asistuar vazhdimisht te asamblistët për ndërrimin e fjalëkalimit dhe problemet me llogari zyrtare

